



Bashkimi Evropian Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve

KUMTESË PËR SHTYP: BE MVZ /2013/08

71 Vëzhgues të Bashkimit Evropian do të shpërndahen në tërë Kosovën në ditën e zgjedhjeve

Prishtinë, 29 nëntor 2013 – Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (BE MVZ) ka shpërndarë sot 31 Vëzhgues Afatshkurtër (VASH) në tërë Kosovën për të monitoruar balotazhin në zgjedhjet për kryetarë të komunave që do të mbahet të dielën më 1 dhjetor 2013.

Gjithsej numri i vëzhguesve të BE-së në ditën e zgjedhjeve do të jetë 71, me shpërndarjen shtesë të vëzhguesve nga ambasadat lokale krahas 20 Vëzhguesve Afatgjatë dhe ekspertëve nga ekipet qendrore që kanë qenë të pranishëm në Kosovë për disa javë për të vlerësuar tërë procesin e zgjedhjeve.

Vëzhguesit janë vijnë nga 26 shtetet anëtare të BE-së si dhe Norvegjia dhe Zvicra.

“Shpresoj që prania e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve do të ndihmojë në rritjen e besimit në procesin zgjedhor dhe se njerëzit do të inkurajohen që të votojnë në një mjedis paqësor”, tha Peter Palmer, Zëvendës shef i Misionit, gjatë shpërndarjes së vëzhguesve afatshkurtër.

Ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit do t'i vizitojnë vendvotimet për të monitoruar hapjen e tyre si dhe procesin e votimit dhe numërimit. Pastaj, ata do të vëzhgojnë ankesat dhe parashtrësat dhe shpalljen e rezultateve.

Pas ditës së zgjedhjeve, Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve do të lëshojë një vlerësim preliminar të procesit. Raporti përfundimtar, me rekomandime për zgjedhjet e ardhshme, do të publikohet në fillim të vitit 2014.

Pyetjet e përfaqësuesve të mediave duhet t'i drejtohen Florence Marchal, Zyrtare e BE MVZ për Media dhe Komunikim me Publikun në numrin e telefonit +386 49 73 77 08 apo adresën e postës elektronike – florence.marchal@eueomkosovo2013.eu

- Na ndiqni në *Twitter* - <https://twitter.com/EUEOMKosovo>
- Një përzgjedhje e fotografive të misionit, me rezolucion të lartë, është në dispozicion në *Flickr* <http://www.flickr.com/photos/eueomkosovo/> - Citimet e fotografive duhet të jenë me referencë në *BEMVZ Kosovë 2013*. Me shkarkimin e tyre, pajtoheni që fotografitë t'i përdorni në pajtim me këto kufizime.

Bashkimi Evropian
Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve

Hoteli Emerald, Autostrada Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 777 200 Faks : +381 38 777201
www.eueom.eu/kosovo2013